

VENDIM
Nr.866, datë 12.8.2009

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES DHE TË PROTOKOLLIT ZBATUES TË SAJ,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË, NË FUSHËN E PUNËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes dhe të protokollit zbatues të saj, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, në fushën e punës, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
DYPALËSHE NË FUSHËN E PUNËS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Italiane, të emërtuara këtu në vijim “Palët kontraktuese”;

me objektivin për të forcuar marrëdhëniet e miqësisë dhe të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve;

duke pasur parasysh parimet e sanksionuara nga instrumentet ndërkombëtarë në lidhje me të drejtat e punonjësve migrantë dhe me të drejtat themelore të punonjësve;

me qëllim që të administrohen në mënyrë të bashkërenduar dhe të efektshme flukset e punonjësve migrantë në drejtim të të dy shteteve;

me objektivin e përforcimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit që ekzistojnë ndërmjet palëve kontraktuese në kuadrin e interesave të përbashkëta për të dy vendet,

ranë dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

- Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

- Për Qeverinë e Republikës Italiane: Ministria e Punës, Shëndetit dhe e Politikave Sociale.

Neni 2

Autoritetet kompetente do të bashkëpunojnë për rregullimin dhe për organizimin e flukseve të punonjësve ndërmjet dy vendeve dhe do të lehtësojnë rekrutimin dhe futjen e shtetasve të palës tjetër në tregun e brendshëm të punës, në rast mungese të krahut të punës vendas.

Neni 3

Mbi bazën e kushteve të tregut të punës dhe sipas legjislacionit kombëtar në fuqi, pala italiane do

të shqyrtojë pozitivisht dhënien e një kuote të rezervuar hyrjesh për shtetasit shqiptarë.

Neni 4

Shtetasit shqiptarë që kërkojnë të ushtrojnë një aktivitet pune pranë një punëdhënësi, edhe sezonale, në Itali, mund të përfshihen në një listë të hartuar nga pala shqiptare, sipas kriterëve të treguara nga pala italiane mbi bazën e legjislacionit të vet.

Lista do t'i përcillet në mënyrë telematike nga pala shqiptare palës italiane, e cila do ta përhapë sipas mënyrave të parashikuara nga dispozitat ligjore italiane.

Neni 5

Një përqindje e kuotës së privilegjuar që i është caktuar Shqipërisë, e barabartë me një të katrën e totalit, mund të përdoret me përparësi përmes sistemit të listave të përmendura në nenin 4.

Neni 6

Palët kontraktuese do të shkëmbejnë rregullisht informacione në lidhje me dy tregjet e punës. Palët kontraktuese marrin përsipër që të lehtësojnë takimin ndërmjet kërkesës dhe ofertës së punës, edhe nëpërmjet mbështetjes dhe asistencës ndaj organizmave kompetentë në këtë sektor në të dyja vendet, dhe të kryejnë monitorimin e ofertave të punës të disponueshme në njërin apo në tjetrin vend.

Neni 7

Palët kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, do të nxisin formimin e punonjësve që do të jenë kandidatë për të migruar në vendin tjetër, me qëllim që të japin personel të kualifikuar që t'i përgjigjet profileve profesionale të kërkuara nga tregu i punës i vendi pritës.

Neni 8

Palët kontraktuese do të nxisin pjesëmarrjen e kandidatëve të mundshëm për emigracion në kurse formimi profesional dhe të gjuhës italiane të organizuara në Shqipëri.

Neni 9

Hyrja, qëndrimi dhe aktiviteti i punonjësit që do të emigrojë, do të kryhen në përputhje me ligjet në fuqi në vendin pritës.

Neni 10

Punonjësit e palëve kontraktuese, rezidentë në territorin e vendit tjetër për arsye pune, munden t'i transferojnë fitimet e tyre në vendin e origjinës, në përputhje me ligjet në fuqi në vendin pritës.

Neni 11

Shtetasit e të dyja palëve kontraktuese, që ushtrojnë një aktivitet pune në territorin e palës tjetër, gëzojnë të njëjtat të drejta dhe të njëjtat mbrojtje që gëzojnë edhe punonjësit e vendit pritës, përsa u përket qoftë kushteve të punës, mbrojtjes shoqërore, përfitimeve shoqërore, qoftë të drejtave themelore të punonjësve, në përputhje me ligjet në fuqi në vendin pritës.

Neni 12

Përfaqësuesit e palëve kontraktuese do të këshillohen rregullisht, me qëllim që:

- Të ndjekin zbatimin e marrëveshjes dhe të propozojnë çfarëdolloj mase, e cila mund të sigurojë

funksionimin e mirë të saj;

- të kryejnë një vlerësim periodik të marrëveshjes;
- Të zgjidhin vështirësitë me karakter praktik, të cilat mund të pengojnë zbatimin e marrëveshjes;
- Të propozojnë ndryshime në marrëveshje.

Neni 13

Mënyrat e zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të përcaktohen nga protokollet zbatuese që do të hyjnë në fuqi sipas procedurave të brendshme të parashikuara nga secila prej dy palëve kontraktuese.

Neni 14

Palët kontraktuese, me marrëveshje të përbashkët, mund të nënshkruajnë protokolle shtesë që do të hyjnë në fuqi sipas procedurave të brendshme të parashikuara nga secila prej dy palëve kontraktuese.

Neni 15

Kjo marrëveshje ka një kohëzgjatje të pacaktuar, me përjashtim të denoncimit, për të cilin njëra prej palëve kontraktuese njofton palën tjetër në rrugë diplomatike.

Denoncimi do të hyjë në fuqi pasi të kenë kaluar 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga njoftimi i tij.

Neni 16

Të dyja palët kontraktuese marrin përsipër, secila në territorin e vet kombëtar, që të nxisin njohjen e gjerë të dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

Neni 17

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas marrjes së njoftimit të fundit, me anën e të cilit të dyja palët do t'i bëjnë të ditur njëra-tjetrës përmbyshjen e procedurave të brendshme, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Me bindje për sa më sipër, të nënshkruarit, përfaqësues të autorizuar nga qeveritë përkatëse, nënshkruan këtë marrëveshje.

Hartuar në Tiranë, më 2 dhjetor 2008, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, italiane dhe angleze të gjitha tekstet njësoj të barasvlefshme. Në rast mosmarrëveshje, do të merret për bazë teksti në anglisht.

**PROTOKOLLI ZBATUES I MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE NË FUSHËN E
PUNËS**

Neni 1

Ky protokoll rregullon hyrjen në Itali për arsye pune pranë një punëdhënësi, sezonale dhe jo sezonale, të shtetasve shqiptarë, në përputhje me ligjet italiane në fuqi mbi hyrjen në territorin e Republikës Italiane për arsye pune të shtetasve që nuk i përkasin Bashkimit Europian.

Neni 2

Ky protokoll zbatohet për shtetasit shqiptarë, kandidatë për të kryer një punë pranë një punëdhënësi, sezonale ose jo sezonale, në territorin italian.

Neni 3

Me qëllim që të lehtësohet rregullimi dhe organizimi i flukseve të punonjësve shqiptarë në drejtim të Italisë, pala italiane do t'i japë palës shqiptare informacione të hollësishme mbi ofertat e punës që vijnë nga punëdhënësit italianë.

Ajo do të japë, gjithashtu, edhe informacione që kanë të bëjnë me legjislacionin italian në çështjet e kushteve të punës, banesës dhe sigurisë shoqërore në Itali.

Informacione të hollësishme do të përmbajë edhe kontrata e punës që punëdhënësi do t'i paraqesë punonjësit.

Autoritetet shqiptare do t'u bëjnë të ditur autoriteteve italiane se në çfarë mase mund të përmbushin këto nevoja.

Neni 4

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me anën e Drejtorisë së Politikave të Migracionit, do të veprojë mbi bazën e prirjeve të tregut të punës dhe të ofertave të punës të sistemit kombëtar për hartimin e një liste kandidatësh shqiptarë përkatës.

Lista e kandidatëve e përpunuar për këtë qëllim, do të ketë parasysh kriteret e përcaktuara nga Ministria Italiane e Punës, e Shëndetit dhe e Politikave Sociale dhe do të përfshijë, ndër të tjera, informacione në lidhje me arsimimin e punonjësve, me kualifikimin e tyre dhe përvojën profesionale, si edhe nivelin e tyre të njohjes së gjuhës italiane.

Kjo listë i përcillet në mënyrë telematike Ministrisë Italiane të Punës, Shëndetit dhe e Politikave Sociale, nëpërmjet përfaqësive diplomatike dhe konsullore, nga organizmat shqiptarë kompetentë, në mënyrë që ajo t'u shpërndahet punëdhënësve italianë.

Punëdhënësit italianë që interesohen për kandidatët e treguar në listë, mund të kontaktojnë Shërbimin Kombëtar të Punësimit, që merr përsipër të lehtësojë takimin e tyre me kandidatët e përzgjedhur.

Neni 5

Përzgjedhja përfundimtare e kandidatëve do të jetë në ngarkim të punëdhënësve ose të përfaqësuesve të tyre në qoftë se do të jetë e nevojshme me bashkëpunimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Neni 6

Punësimi i punonjësve shqiptarë do të kryhet me kontratë pune individuale, të hartuar sipas kushteve të parashikuara nga ligjet italiane në fuqi.

Kandidatët e përzgjedhur duhet të gëzojnë kushtet shëndetësore që i bëjnë ata të aftë për kryerjen e funksioneve për të cilat janë caktuar që të punojnë në Itali dhe do të mund t'i nënshtrohen një kontrolli mjekësor në ngarkim të punëdhënësit.

Neni 7

Palët kontraktuese do të mbështesin aktivimin e kurseve të formimit profesional dhe të mësimi të gjuhës italiane për shtetasit shqiptarë kandidatë për të punuar në Itali, të organizuar në territorin shqiptar, sipas kushteve të përcaktuara me marrëveshje të përbashkët.

Kurset e formimit profesional dhe të mësimi të gjuhës italiane, të parashikuara nga neni 23 i ligjit italian mbi emigracionin, do të organizohen sipas dispozitave në vijim:

- Programet e formimit të miratuara nga Ministria Italiane e Punës, Shëndetit dhe e Politikave Sociale i komunikohen Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
- Programet e formimit do të organizohen dhe do të realizohen sipas ligjeve shqiptare në fuqi.
- Kandidatët shqiptarë që do të kenë marrë pjesë në kurse formimi, pavarësisht edhe nga ofertat e

punës, do të përfshihen në një listë me përparësi, me qëllim që të fitojnë një të drejtë përparësie për hyrjen në Itali për arsye pune.

- Të gjitha shpenzimet e formimit do të jenë vetëm në ngarkim të punëdhënësve ose të subjekteve organizuese të formimit.

Neni 8

Kandidatët për një ofertë pune do të informohen se me të mbaruar afati i lejes së tyre të qëndrimit për arsye pune, sezonale ose josezonale, duhet të largohen nga territori italian, në përputhje me ligjet kombëtare italiane në fuqi dhe t'u vendoset në pasaportën e tyre vula e daljes, pasi t'u kenë dorëzuar lejen e qëndrimit organeve të policisë kufitare italiane.

Neni 9

Konsultimet e parashikuara nga neni 12 i marrëveshjes do të zhvillohen në kuadrin e takimeve ndërmjet përfaqësuesve të autoriteteve kompetente të të dyja palëve.

Neni 10

Ky protokoll përmban dispozitat për zbatimin e marrëveshjes dhe do të hyjë në fuqi në të njëjtën ditë me marrëveshjen. Palët kontraktuese mund të bëjnë ndryshime në këtë protokoll, me marrëveshje të përbashkët, në rrugë diplomatike.

Neni 11

Për aspektet që nuk janë rregulluar nga marrëveshja ose nga ky protokoll, palët do t'i referohen legjislacionit italian në lidhje me çështjet e hyrjes, të punësimit dhe të qëndrimit të punonjësve të vendeve që nuk i përkasin Bashkimit Europian, si edhe mënyrave të zbatimit të ndërmarra nga autoritetet kompetente italiane.

Hartuar në Tiranë, më 2 dhjetor 2008, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, italiane dhe angleze, të gjitha tekstet njësoj të barasvlefshme. Në rast mosmarrëveshje, do të merret për bazë teksti në anglisht.